

me4.eu  
eu4.me  
ja za evropu, evropa za mene

# EKIPI NEGOCIATOR



eu  
me

---

*Shprehjet që në këtë fletëpalosje përdoren për persona fizikë në gjini mashkullore nënkuptojnë të njëjtat shprehje edhe në gjini femërore.*

---

## FJALA HYRËSE E KRYENEGOCIATORIT

Mali i Zi ka hyrë me sukses në vitin e tretë të negociatave për aderim në BE. Rezultatet që i kemi arritur paraqesin bazën e mirë për suksese të reja evropiane. Dëshmojnë se përpjekjet dhe puna jonë janë vlerësuar dhe na motivojnë që të vazhdojmë me të njëjtin zell.

Vlera e posaçme e dy viteve të para të negociatave është se kemi përforcuar dialogun dhe bashkëpunimin e brendshëm lidhur me çështjen e aderimit në BE. Ideja e integritimit evropian si detyrë e brendshme dhe qëllimit nga i cili do të përfitojnë të gjithë qytetarët tanë e ka bashkuar tërë kapitalin njerëzor të disponueshëm të vendit përmes ngërthimit të njohurive, përvojës dhe energjisë së nevojshme.

Vitin e parë të negociatave e kanë shënuar formimi i strukturës për negociata që përfshinë mbi 1300 persona dhe mbajtja e takimeve të vlerësimit shpjegues (explanatory screening) dhe bilateral që kanë zgjatur nga marsi i vitit 2012 deri më 28 qershor 2013. Skrining-u ka ndihmuar të vëzhgohet gjendja në të gjitha fushat dhe të vërehen sfidat më të mëdha institucionale, juridike dhe investuese për Malin e Zi.

Sukses të veçantë për administratën dhe shoqërinë malazeze në përgjithësi gjatë dy viteve të fundit paraqet mbyllja e përkohshme e negociatave në dy kapitujt, e 25-të Shkenca dhe kërkimi dhe 26-të Arsimit dhe kultura, si dhe hapja e negociatave në dhjetë kapituj: 4. Lëvizja e lirë e kapitalit, 5. Prokurimet publike, 6. Ligji për shoqëritë tregtare, 7. Ligji për pronësinë intelektuale, 10. Shoqëria e informacionit dhe mediat, 20. Politika e ndërmarrjeve dhe e industrisë, 23. Gjyqësori dhe të drejtat themelore, 24. Drejtësia, liria dhe siguria, 31. Politika e jashtme, e sigurisë dhe e mbrojtjes dhe 32. Kontrolli financiar.

Këto suksese janë vërtetim i punës së përkushtuar, sukseseve të mira dhe stimulim që të vazhdojmë edhe më mirë.

Në vitet e ardhshme të negociatave do të vazhdojmë me reforma që kanë për qëllim stabilitetin e vazhduar politik dhe demokratik, krijimin e ambientit që do të avancojnë rritjen ekonomike dhe zhvillimin në drejtim të përmirësimit të standardit të jetës së qytetarëve tonë dhe që do të kanë efekte pozitive konkrete në të gjitha fusha.

Përveç punës në harmonizimin e legjislacionit të brendshëm me rregullat evropiane në të gjitha fushat dhe zbatimin të tij adekuat, fokusi do të jetë në përforcimin e mëtejshëm të kapaciteteve tona administrative dhe ndërtimit të institucioneve të reja.

Anëtarësimi në Bashkimin Evropian hap shumë mundësi, por për këto nevojitet që të përgatitemi më kohë duke përforcuar kapacitetet, duke ndërtuar ekspertizën përmes avancimit të njohurive dhe aftësive të duhura, duke përforcuar konkurrencën dhe duke ngritur cilësinë. Prandaj, bisedat për anëtarësim duhet të kuptohen si një mekanizëm që do të na përgatitë për rregullat që vlejné brenda BE-së.

Sot jemi më të pasur për një përvojë dyvjeçare dhe më të gatshëm i presim detyrat e reja evropiane.

Podgoricë, Tetor 2014

Kryenegociator  
Ambasadori Aleksandër Andrija PEJOVIQ

Më datë 9 dhjetor 2011 Këshilli Evropian i ka pranuar rekomandimet e Komisionit Evropian nga data 12 tetor 2011 mbi hapjen e negociatave me Malin e Zi në qershor të vitit 2012.

*„Këshilli Evropian përshëndet vlerësimin e Komisionit mbi përparimin e mirë që ka realizuar Mali i Zi, me çfarë janë arritur rezultatet e përgjithshme të mjaftueshme. Me qëllim të hapjes së negociatave për anëtarësim me Malin e Zi në qershor të vitit 2012, Këshilli Evropian detyron Këshillin që të shqyrtojë përparimin e Malit të Zi në zbatimin e reformave, duke u fokusuar veçanërisht në fushën e sundimit të së drejtës dhe lirive themelore, posaçërisht në luftë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, në bazë të raportit që do të paraqesë Komisioni në gjysmën e parë të vitit 2012. Thirret Komisioni që të paraqesë pa vonesë suazën për negociatave me Malin e Zi, në përputhje me përfundimet nga dhjetori i vitit 2006 dhe praktikën e vendosur, gjithashtu të kyçë qasjen e re që ka propozuar Komisioni në pikëpamje të kapitujve mbi gjyqësorin dhe të drejtat themelore dhe drejtësinë, lirinë dhe sigurinë. Komisioni, në këtë kontekst, gjithashtu thirret të iniciojë procesin e shqyrtimit analitik të përputhshmërisë së trashëgimisë ligjore të BE-së me Malin e Zi në kapitujt e lartpërmendur.“*

Pas vendimit të Këshillit Evropian mbi fillimin e negociatave me Malin e Zi, më datën 29 dhjetor 2011 Qeveria e Malit të Zi ka emëruar ambasadorin Aleksandër Andrija Pejoviq për Kryenegociator për udhëheqje të negociatave mbi anëtarësim të Malit të Zi në Bashkim Evropian, ndërsa më 2 shkurt 2012 është marrë vendimi mbi vendosjen e strukturës për negociatave të Malit të Zi me BE-në.

Ka vijuar formimi i 33 grupeve të punës për udhëheqje të negociatave sipas kapitujve të veçanta të trashëgimisë juridike të BE-së dhe emërimi i 10 negociatorëve – anëtarëve të Grupit negociator.

Struktura për negociatave sot ka më shumë se 1300 anëtarë duke përfshirë përfaqësuesit e të gjitha strukturave shoqërore, institucioneve shtetërore, komunitetit akademik dhe sektorit civil. Një e treta e të gjithë anëtarëve të strukturës për negociatave përbëhet nga përfaqësuesit e shoqërisë civile, ndërsa 55% të strukturës e përbëjnë femrat. Në përputhje me fazat e procesit të negociatave, struktura për negociatave merr pjesë si në përgatitjen dhe në takimet e shqyrtimit analitik të legjislacionit (screening), takimet teknike, përgatitjet dhe hartimin e pozitave të Malit të Zi në negociatave, ashtu dhe në përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga dokumentet e negociatave.

Më 29 prill 2012 në Bruksel është mbajtur Konferenca ndërqeveritare mes Malit të Zi dhe BE-së me të cilën zyrtarisht kanë filluar negociatat mbi anëtarësim. Në këtë Konferencë ndërqeveritare



kanë marrë pjesë Komisionari Evropian për Zgjerim dhe Politika Fqinjësore Stefan Fyle, dhe ministri danez për punë evropiane dhe kryesuesi i Këshillit të BE Nikollaj Vamen, ndërsa delegacionin malazet e ka udhëhequr Ministri i Punëve të Jashtme dhe Integritimit Evropian Millan Roqen.

*Hapja e negociatave për anëtarësim,  
Bruksel, më 29 prill 2012*

## PROCESI I HAPJES SË NEGOCIATAVE SIPAS KAPITUJVE

DHJETOR 2012 – QERSHOR 2014





STRUKTURA  
PËR UDHËHEQJEN E  
NEGOCIATAVE PËR  
ANËTARËSIMIN E  
MALIT TË ZI  
NË BASHKIMIN EVROPIAN






Struktura për negociata mbi anëtarësimin e Malit të Zi në Bashkimin Evropian është themeluar me Vendim të Qeverisë së Malit të Zi me datën 2 shkurt 2012.

Me këtë Vendim janë formuar këto trupe:

- Kolegji për negociata
- Delegacioni shtetëror
- Këshilli për sundimin e së drejtës (i formuar më 6 mars 2014 me Vendim mbi ndryshime dhe plotësime të Vendimit mbi formimin e strukturës për negociata mbi anëtarësimin e Malit të Zi në Bashkimin Evropian)
- Grupi i negocimit
- Grupet e punës
- Zyra për mbështetje të Kryenegociatorit
- Sekretariati i grupit të negocimit



## KËSHILLI PËR NEGOCIATA

Trupi punues i Qeverisë që shqyrton propozimet e pozitive për negociata dhe pas procedurës së zbatuar në trupin punues kompetent të Kuvendit të Malit të Zi i dorëzon Qeverisë për miratim.

Anëtarët e Kolegjit janë Kryeministri, zëvendëskryeministrat dhe Kryenegociatori. Në punën e Kolegjit për negociata mund të marrin pjesë edhe ministra të tjerë. Në seanca të Kolegjit për negociata diskutohen të gjitha çështjet e lidhura me negociata dhe vendoset mbi çështjet më të ndjeshme që rrjedhin nga procesi i negociatave. Deri tani janë mbajtur nëntë seanca të Kolegjit.

## DELEGACIONI SHETETËROR PËR NEGOCIATA MBI ANËTARËSIMIN E MALIT TË ZI NË BASHKIMIN EVROPIAN

Delegacioni shtetëror udhëheq bisedat dhe negociatat e drejtpërdrejta politike me vendet anëtare dhe institucionet e Bashkimit Evropian dhe është përgjegjës për zhvillimin e suksesshëm të negociatave sipas të gjitha kapitujve të negociatave – trashëgimisë juridike të Bashkimit Evropian. Delegacioni shtetëror përgjigjet para Qeverisë për punën e vet dhe vepron në përputhje me udhëzimet për negociata që i miraton Qeveria. Delegacioni shtetëror i raporton Qeverisë mbi gjendjen e negociatave pas çdo takimi të Konferencës ndërqeveritare mes Malit të Zi dhe vendeve anëtare të Bashkimit Evropian në nivelin ministror dhe parashtron raportet e posaçme sipas kërkesës së Qeverisë.

Anëtarët e Delegacionit shtetëror janë shefi i Delegacionit shtetëror – ministri i punëve të jashtme dhe integritimit evropian, zëvendësi i shefit të delegacionit – Kryenegociatori; zëvendësit e Kryenegociatorit; shefi i Misionit të Malit të Zi pranë Bashkimit Evropian dhe sekretari i grupit negociator.

Delegacioni shtetëror deri tani ka marrë pjesë në katër Konferenca ndërqeveritare në nivelin ministror dhe në dy Konferenca ndërqeveritare në nivelin e zëvendësve.

Delegacionin e parë shtetëror në Konferencë ndërqeveritare në nivelin ministror, me rastin e hapjes së procesit të negociatave me Malin e Zi, më datë 29 prill 2012 e ka udhëhequr ministri i atëhershëm i punëve të jashtme dhe integritimit evropian, zoti Millan Roqen. Anëtarë të delegacionit ishin dhe Kryenegociatori ambasador Aleksandër Andrija Pejoviq, ambasadori i Malit të Zi pranë BE-së Ivan Llekoviç dhe sekretari i Grupit negociator Millivoje Jurishiq.



*Hapja dhe mbyllja e përkohshme e kapitullit 25 – Shkenca dhe kërkimi, Bruksel, më 18 dhjetor 2012*

Delegacionin shtetëror të Malit të Zi në Konferencën e dytë ndërqeveritare, lidhur me mbylljen e përkohshme të procesit të negociatave në kapitullin Shkenca dhe kërkimi, më datë 18 dhjetor 2012 e ka udhëhequr ministri Igor Llukshiq, ndërsa anëtarë të tjerë të delegacionit ishin ministrja e shkencës, zonja Sanja Vllahoviq, Kryenegociatori ambasador Aleksandër Andrija Pejoviq, ambasadori Ivan Llekoviç dhe sekretari i Grupit negociator Millivoje Jurishiq.



*Hapja dhe mbyllja e përkohshme e kapitullit 26 – Arsimi dhe kultura, Bruksel, më 15 prill 2013*

Delegacionin shtetëror të Malit të Zi në Konferencën e parë ndërqeveritare në nivelin e zëvendësve, me rastin e mbylljes së përkohshme të procesit të negociatave në kapitullin Arsimi dhe kultura, më datë 15 prill 2013 e ka udhëhequr Kryenegociatori ambasador Aleksandër Andrija Pejoviq, ndërsa anëtarët ishin ambasadori i Malit të Zi pranë BE Ivan Llekoviq, anëtarë i Grupit negociator për kapitullin 26 prof. Angjellko Llojpur, shefja e grupit të punës për kapitullin 26 Mubera Kurpejoviq dhe sekretari i Grupit negociator Millivoje Jurishiq.



*Hapja e kapitujve 5, 6, 20, 23 dhe 24, Bruksel, më 18 dhjetor 2013*

Delegacionin shtetëror të Malit të Zi në Konferencën e tretë ndërqeveritare në nivelin ministror, me rastin e hapjes së procesit të negociatave në pesë kapituj, duke përfshirë edhe kapitullin mbi sundimin e së drejtës, më datë 18 dhjetor 2013 e ka udhëhequr ministri Igor Llukshiq, ndërsa anëtarët e delegacionit ishin ministri i drejtësisë Dushko Markoviq, ministri i punëve të brendshme Rashko Konjeviq, Kryenegociatori ambasador Aleksandër Andrija Pejoviq, ambasadori Ivan Llekoviq dhe sekretari i Grupit negociator Millivoje Jurishiq.



*Hapja e kapitujve 7-E drejta e pronësisë intelektuale dhe 10 - Shoqëria e informacionit dhe mediat, Bruksel, më 31 mars 2014*

Delegacionin shtetëror të Malit të Zi në Konferencën e dytë ndërqeveritare në nivelin e zëvendësve, me rastin e hapjes së procesit të negociatave në kapituj Shoqëria e informacionit dhe mediat dhe Ligji mbi pronësinë intelektuale, më datë 31 mars 2014 e ka udhëhequr Kryenegociatori ambasador Aleksandër Andrija Pejoviq, ndërsa anëtarët e delegacionit ishin ambasadori i Malit të Zi pranë BE Ivan Llekoviq, shefi i grupit të punës për kapitullin 7 Novak Axhiq, shefja e grupit të punës për kapitullin 10 Ruzhica Mishkoviq dhe sekretari i Grupit negociator Millivoje Jurishiq.



Delegacionin shtetëror të Malit të Zi në Konferencën e katërt ndërqeveritare në nivelin ministror, me rastin e hapjes së procesit të negociatave në tre kapituj, më datë 24 qershor 2014 e ka udhëhequr ministri Igor Llukshiq, ndërsa anëtarët e delegacionit ishin Kryenegociatori ambasador Aleksandër Andrija Pejoviq, ambasadori Ivan Llekoviç dhe sekretari i Grupit negociator Millivoje Jurishiq.

*Hapja e kapitujve 4 - Lëvizja e lirë e kapitalit, 31- Politika e jashtme, e sigurisë dhe e mbrojtjes dhe 32- Kontrolli financiar, Bruksel, më 24 qershor 2014*

## KËSHILLI PËR INTEGRIMIN EVROPIAN

Kuvendi i Malit të Zi luan rolin e rëndësishëm në mbikëqyrjen e zhvillimit të negociatave të aderimit në BE dhe harmonizimit të legjislacionit malazez me trashëgiminë juridike të BE-së.

Me qëllim të përforcimit të rolit të Kuvendit në procesin e integrimit në BE, në maj të vitit 2012 është miratuar Vendimi mbi ndryshimet dhe plotësimet e rregullores së punës së Kuvendit të Malit të Zi me të cilën në vend të Këshillit të mëparshëm për marrëdhënie ndërkombëtare dhe integrimin evropian janë formuar dy këshille – Këshilli për marrëdhënie ndërkombëtare dhe mërgimtarët dhe Këshilli për integrimin evropian, i cili është trupi kryesor i kuvendit për përcjellje të procesit të negociatave me BE.

Në kompetencë të Këshillit për integrimin evropian është përcjellja e negociatave mbi anëtarësimin e Malit të Zi në Bashkimin Evropian, mbikëqyrja dhe vlerësimi i procesit të negociatave dhe dhënia e mendimeve dhe udhëzimeve në emër të Kuvendit mbi pozitat e përgatitura për negociata. Gjithashtu Këshilli shqyrton informacionet mbi procesin e negociatave dhe shqyrton dhe jep mendime mbi çështjet që hapen gjatë negociatave dhe shqyrton dhe vlerëson veprimtarinë e ekipit negociator. Këshilli ka kryetarin dhe dymbëdhjetë anëtarë.

Me miratimin e Rezolutës mbi mënyrën, cilësinë dhe dinamikën e procesit të integrimit të Malit të Zi në Bashkimin Evropian, në dhjetor të 2013, posaçërisht është përcaktuar pozita e Kuvendit të Malit të Zi dhe Këshillit për integrimin evropian në procesin e negociatave.

## KËSHILLI PËR SUNDIMIN E SË DREJTËS

Me hapjen e negociatave në kapitujt 23 dhe 24, Mali i Zi ka hy në një fazë të re dhe sfiduese, çfarë nënkupton një punë të vazhdueshme dhe bashkërendimin efikas të aktiviteteve në fushën e sundimit të së drejtës. Prandaj është treguar si e nevojshme formimi i trupit që, në kuadër të strukturës ekzistuese për negociata, do të jetë përgjegjës për përcjelljen e punës së organeve shtetërore, organeve të administratës publike dhe organeve dhe institucioneve të tjera në fushën e sundimit të së drejtës, me qëllim të avancimit të zbatimit të detyrave prioritare në procesin e negociatave në këtë fushë.

Me ndryshime dhe plotësime të Vendimit mbi formimin e strukturës për negociata mbi anëtarësimin e Malit të Zi në Bashkimin Evropian që e ka miratuar Qeveria më datë 6 mars 2014, është formuar Këshilli për sundimin e së drejtës si një organ për përcjellje të negociatave në fushën e sundimit të së drejtës, gjegjësisht në kapitujt 23 dhe 24.

Këshilli përbëhet nga kryetari, nënkryetari dhe 39 anëtarë. Kryetari i Këshillit është zëvendëskryeministri për sistemin politik, politikën e brendshme dhe të jashtme. Zëvendësi i kryetarit është ministri i punëve të brendshme. Anëtarët e këshillit janë: sekretari i përgjithshëm i Kuvendit të Malit të Zi, sekretari i përgjithshëm i Qeverisë, ministri i mbrojtjes, ministri i financave, ministri i punëve të jashtme dhe integritimit evropian, ministri i arsimit, ministri i kulturës, ministri i ekonomisë, ministri i komunikacionit dhe detarisë, ministri i zhvillimit të qëndrueshëm dhe turizmit, ministri i shëndetësisë, ministri i të drejtave të njeriut dhe të pakicave, ministri i shoqërisë së informacionit dhe telekomunikimeve, ministri i punës dhe përkujdesjes sociale, kryenegociatori për udhëheqjen e negociatave për anëtarësim të Malit të Zi në Bashkimin Evropian, kryetari i Gjykatës supreme të Malit të Zi, Kryeprokurori, kryetari i Këshillit gjyqësor, Avokati i popullit, drejtori i Agjencisë për sigurinë kombëtare, drejtori i Drejtorisë së policisë, drejtori i Drejtorisë së doganave, drejtori i Drejtorisë për punë inspektuese, drejtori i Drejtorisë për nismë kundër korrupsionit, drejtori i Drejtorisë së prokurimeve publike, drejtori i Drejtorisë për parandalim të spastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, drejtori i Drejtorisë për përkujdesjen e refugjatëve, drejtori i Drejtorisë për menaxhimin e burimeve njerëzore, drejtori i Drejtorisë për patundshmëri, drejtori i Drejtorisë për pasuri, kryetari i Komisionit shtetëror për kontrollin e procedurave të prokurimeve publike, drejtori i Drejtorisë për mbrojtjen e të dhënave sekrete, kryetari i Komisionit për parandalim të konfliktit të interesave, drejtori i Agjencisë për mbrojtjen e të dhënave personale dhe qasjen e lirë tek informacioni, drejtori i Institutit publik Shkolla e lartë profesionale "Akademia policore", kryetari i Komisionit qendror të zgjedhjeve, kryetari i Këshillit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, drejtori ekzekutiv i Qendrës për trajnim të mbartësve të funksioneve gjyqësore, sekretari i përgjithshëm i Shoqatës së bashkive të Malit të Zi.

Kompetencat e Këshillit janë përcjellja e përbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga kapitujt 23. Gjyqësori dhe të drejtat themelore dhe 24. Drejtësia, liria dhe siguria, kërkimi i shkaqeve të vonësës në përbushjen e detyrimeve dhe dhënia e rekomandimeve organeve shtetërore, organeve të administratës shtetërore dhe organeve dhe institucioneve të tjera për veprim urgjent për të zbatuar detyrimet nga këto kapituj, si dhe kryerja e punëve të tjera që rrjedhin nga Vendimi mbi formimin e strukturës për negociata.

## GRUPI NEGOCIATOR

Grupi negociator merret me nivelin profesional dhe teknik të negociatave me institucione dhe vende anëtare të Bashkimit Evropian sipas të gjitha kapitujve të negociatave – trashëgimisë juridike të Bashkimit Evropian.

Grupi negociator shqyrton dhe përcakton propozimet e pozitive për negociata dhe për punë të vetë i përgjigj shefit të Delegacionit shtetëror dhe Qeverisë. Grupi negociator i kryen punët në përputhje me udhëzime dhe instruksione të shefit të Delegacionit shtetëror. Grupi negociator i raporton shefit të Delegacionit shtetëror dhe Qeverisë mbi gjendjen e negociatave pas çdo takimit të Konferencës ndërqeveritare, dhe parashton raportet e posaçme në raste kur këto kërkohen nga shefi i Delegacionit shtetëror dhe Qeveria. Deri tani janë mbajtur 13 takime të Grupit negociator.

Grupin negociator e përbëjnë kryenegociatori, dhjetë anëtarë të grupit negociator përgjegjës për kapituj të veçantë të negociatave, shefi i Misionit të Malit të Zi pranë BE-së dhe shefi i sekretariatit të grupit negociator. Grupi negociator deri tani ka mbajtur 13 takime gjatë të cilëve janë diskutuar 23 pozita për negociata, 2 raporte mbi detyrimet e përmbushura në kapitullin e negociatave si dhe 10 raporte mbi kapitullin e negociatave.

Emërimi i negociatorëve malazezë ka ecur paralelisht me formimin e grupeve të punës për udhëheqje të negociatave, nga shkurti i vitit 2012 deri në prill të vitit 2013. Gjatë kësaj periudhe janë emëruar njëmbëdhjetë negociatorë për 33 kapituj të trashëgimisë juridike të BE-s, që përbëjnë Grupin negociator.

Çdo nga njëmbëdhjetë negociatorët është përgjegjës për së paku dy fusha, gjegjësisht kapituj. Edhe nëse dallohen sipas vëllimit dhe ndërlikueshmërisë, çdo kapitull për negociata e ka rëndësinë e vet specifike dhe vlerën për transformimin gjithëpërfshirës të shoqërisë. Nëse trashëgiminë juridike në tërësi e shikojmë si një mozaik të veçantë, atëbotë se cila nga 33 pjesë paraqet një segment me rëndësi të jashtëzakonshme për krijimin e imazhit të plotë.

## NEGOCIATORËT



**Aleksandër Andrija PEJOVIQ**

Kryenegociator dhe negociator për kapitujt 22, 31, 34 dhe 35



**Nikolla FABRIS**

Zëvendësgubernator i Bankës qendrore të Malit të Zi  
Negociator për kapitujt 4, 9, 17 dhe 18



**Angjellko LLOJPUR**

Profesor në Universitetin e Malit të Zi  
Negociator për kapitujt 10, 25 dhe 26



**Arijana NIKOLLIQ**

Drejtoreshë për tregun e punës dhe punësim në Ministri për punë dhe përkujdesje sociale  
Negociatore për kapitujt 2 dhe 19



**Igor NOVELIQ**

Sekretar i Ministrisë së ekonomisë,  
Negociator për kapitujt 1, 8 dhe 30





**Dalliborka PEJOVIQ**

Sekretare shtetërore në Ministrinë e zhvillimit të qëndrueshëm dhe turizmit, Negociatore për kapitujt 27 dhe 28



**Svetllana RAJKOVIQ**

Drejtoare e përgjithshme për bashkëpunimin juridik ndërkombëtar dhe integrimin evropian në Ministrinë e Drejtësisë, Negociatore për kapitujt 23 dhe 24



**Vlladimir SAVKOVIQ**

Doc. dr. në Fakultetin juridik të Universitetit të Malit të Zi, Negociator për kapitujt 3, 6, 7 dhe 20



**Danijella STOLICA**

Zëvendësministre për bujqësi dhe peshkim në Ministri të bujqësisë dhe zhvillimit rural, Negociatore për kapitujt 11, 12 dhe 13



**Nikolla VUKIQEVIQ**

Drejtor i përgjithshëm për buxhetin në Ministrinë e financave, negociator për kapitujt 5, 16, 29, 32 dhe 33



**Angellina ZHIVKOVIQ**

U.D. drejtoare e përgjithshme për akset rrugore shtetërore në Ministrinë e komunikacionit dhe detarisë, Negociatore për kapitujt 14, 15 dhe 21



# GRUPET E PUNËS PËR UDHËHEQJEN E NEGOCIATAVE





Negociatori



Shefi i GP



Sekretari i GP

Grupi i punës është formuar në dhjetor të vitit 2012. Negociator për këtë kapitull është **Igor Noveliq**, sekretar i Ministrisë së Ekonomisë, shefja e grupit të punës është **Nina Vujosheviq**, zëvendësministre e Ekonomisë. Sekretare e grupit të punës është **Tatjana Tomiq**, nga MPJIE. Grupi i punës është i përbërë nga 47 anëtarë (33 nga institucionet shtetërore dhe 14 nga sektori civil).

Lëvizja e lirë e mallrave është një nga katër liritë themelore përmes të cilave sigurohet funksionimi efikas i tregut të brendshëm, gjegjësisht i tregut unik të BE-s. Ky kapitull i referohet largimit të të gjitha barrierave në fushën e tregtisë që pengojnë vendosjen e prodhimeve që janë me origjinë nga vendet e tjera anëtare të Bashkimit në tregje kombëtare. Kjo gjë arrihet përmes harmonizimit të rregullave kombëtare në fusha të standardizimit, akreditimit, metrologjisë, kontrollit të tregut, masat procedurale dhe me direktiva të qasjes së vjetër dhe të re.

Të arrihet harmonizimi me trashëgiminë juridike të BE në këtë kapitull do të thotë të adaptohet ekonomia e vendit në mënyrë që të sigurohet qasja e lirë tregut prej më shumë se 500 milionë konsumatorë dhe 23 milionë shoqëri tregtare.



Negociatori



Shefi i GP



Sekretari i GP

Grupi i punës është formuar në prill të vitit 2013. Negociator për këtë kapitull është **Arijana Noveliq**, drejtore për tregun e punës dhe punësim në Ministrinë e Punës dhe përkujdesjes sociale, shefja e grupit të punës është **Vukica Jelliq**, drejtore e Entit për punësim. Sekretar i grupit të punës është **Srgjan Tomiq**, nga MPJIE. Grupi i punës është i përbërë nga 33 anëtarë (18 nga institucionet shtetërore dhe 15 nga sektori civil).

Qëllimi i politikës së lëvizjes së lirë të punëtorëve është që shtetasit e BE-së mund të lëvizin lirshëm, të qëndrojnë, të studiojnë dhe të punojnë në çdo vend anëtar të BE. Lëvizja e lirë e punëtorëve, që është inkorporuar në Traktate të BE-s, paraqet elementin përbërës të tregut unik dhe elementin qendror të suksesit të tij. Ajo nxit zhvillimin ekonomik duke mundësuar njerëzit të udhëtojnë dhe të blejnë edhe jashtë kufijve të vendit të vet.

Sipas dispozitave të rregullave ligjore të Bashkimit Evropian, punëtori që shpërngulet në një vend tjetër anëtar gëzon disa të drejta të caktuara. Ato janë: e drejta për të punuar pa leje pune, kushtet e barabarta për punësim me shtetasit e vendit anëtarë ku kryhet puna në fjalë, e drejta mbi sigurinë sociale të barabartë siç e kanë edhe shtetasit e vendit anëtar në të cilin punëtori punësohet, të drejtën për anëtarët e familjes që të bashkohen me punëtorin dhe të marrin asistencën familjare, koordinimi i plotë i sistemit të sigurisë sociale dhe njohja e ndërsjellë e kualifikimeve.

EURES është rrjeti evropian i shërbimeve publike për punësim që për qëllim ka promovimin e lirisë së lëvizjes së punëtorëve brenda BE-s, posaçërisht përmes bashkëpunimit të ngushtë mes shërbimeve kombëtare për punësim për shkak të shkëmbimit të informacioneve mbi mundësitë e punësimit.

Karta evropiane e sigurimit shëndetësor (EZKO) është karta që fitohet falas dhe u jep mundësi shtetasve të BE-së që, gjatë qëndrimit të përkohshëm në çdo vend anëtar të BE-së, si dhe në Islandë, Lihtenshtajn, Norvegji dhe Zvicër, të përdorin shërbimet e nevojshme mjekësore me të njëjtat kushte dhe me të njëjtin çmim (falas në disa vende) siç e kanë personat e siguruar në vendin në fjalë.



Negociatori



Shefi i GP



Sekretari i GP

Grupi i punës është formuar në shtator të vitit 2012. Negociator për këtë kapitull është **Vladimir Savkoviq**, doc. dr në Fakultetin juridik të Universitetit të Malit të Zi, shef i grupit të punës është **Pavle Radovanoviq**, sekretar i përgjithshëm i Dhomës së tregtisë. Sekretar i grupit të punës është **Millena Biro**, nga MPJIE. Grupi i punës është i përbërë nga 32 anëtarë (14 nga institucionet shtetërore dhe 18 nga sektori civil).

Harmonizimi me trashëgiminë juridike të BE-s në këtë kapitull do të thotë të përshtatet tregu i vetë kushteve të nevojshme për zhvillim të përgjithshëm të ekonomisë së vendit, si dhe për njohjen e shkallës së arritur të arsimit të shtetasve tonë në vende të BE-s.

Ky kapitull përfshin tri fusha: formimin e ndërmarrjeve, kualifikimet profesionale dhe shërbimet postare.

E drejta mbi formimin e ndërmarrjes do të ofroj mundësi për subjektet tregtare malazeze që të fillojnë dhe të kryejnë veprimtarinë ekonomike në mënyrë stabile dhe të vazhdueshme në një ose më shumë vende të BE-s.

Njohja e ndërsjellë e kualifikimeve profesionale është një pjesë e platformës së ofrimit të shërbimeve në tregun e brendshëm që nënkupton vendosjen e sistemit i cili do të kryejë njohjen automatike të dokumenteve arsimore për profesione të rregulluara (doktor i mjekësisë, doktor i stomatologjisë, veteriner, arkitekt, farmacist, infermiere dhe akushere) që janë marrë në çdo vend anëtarë të BE-së.

Gjithashtu, qëllimi i këtij kapitulli është krijimi i tregut unik për shërbime postare dhe sigurimi i cilësisë së shërbimeve që ofrohen.



Negociatori



Shefi i GP



Sekretari i GP

Grupi i punës është formuar në dhjetor të vitit 2012. Negociator për këtë kapitull është **Nikolla Fabris**, zëvendësguvernator i Bankës Qendrore të Malit të Zi, shef i grupit të punës është **Marijana Mitroviq – Mijatoviq**, drejtore e Sektorit për kërkim dhe statistikë në Bankën Qendrore të Malit të Zi. Sekretar i grupit të punës është **Millena Biro**, nga MPJIE. Grupi i punës është i përbërë nga 33 anëtarë (29 nga institucionet shtetërore dhe 4 nga sektori civil).

Lëvizja e lirë e kapitalit mundëson qarkullimin e mjeteve brenda Bashkimit Evropian, lehtëson tregtinë ndërkufitare, kontribuon lëvizjes së punëtorëve, lehtëson grumbullimin e kapitalit të nevojshëm për veprimtari dhe rritje të subjekteve tregtare dhe funksionimin e tregut të brendshëm të integruar, të hapur dhe efikas, çfarë është në interesin e të gjithë qytetarëve të BE-së. Ky kapitull përfshin rregullat e lëvizjes së lirë të kapitalit mes vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, dhe ato përfshijnë ndalimin e të gjitha restriksioneve në qarkullimin e kapitalit dhe të pagesave.

Harmonizimi me trashëgiminë juridike të BE-së në këtë kapitull do të thotë të harmonizohen ligjet e brendshme dhe tregu i kapitalit kushteve të qarkullimit të papenguar të kapitalit, kushteve të gëzimit të pronësisë pa diskriminim, me qëllim të përforsimit të sistemit të luftës kundër spastrimit të parave. Për qytetarët kjo liri do të mundësojë kryerjen e operacioneve të shumta jashtë kufijve të Malit të Zi, siç janë hapja e llogarive bankare blerja e aksioneve në kompanitë e huaja, investimi atje ku kanë më interes, si dhe blerja e patundshmërive. Për shoqëritë tregtare kjo liri do të mundësojë investimin dhe marrjen në pronë të shoqërive tregtare evropiane dhe rolin aktiv në administrimin e tyre. Për institucionet shtetërore kjo liri do të thotë shkallën më të ulët të kredive, çfarë lehtëson shumë financimin e shpenzimeve për shkollimin, shëndetësinë dhe gjitha format tjera të shpenzimeve publike.



Negociatori



Shefi i GP



Sekretari i GP

Grupi i punës është formuar në korrik të vitit 2012. Negociator për këtë kapitull është **Nikolla Vukiqeviq**, drejtor i përgjithshëm për buxhetin në Ministri të financave, shef i grupit të punës është **Mersad Mujeviq**, drejtor i Drejtorisë për prokurime publike. Sekretar i grupit të punës është **Millena Biro**, nga MPJIE. Grupi i punës është i përbërë nga 29 anëtarë (25 nga institucionet shtetërore dhe 4 nga sektori civil).

Prokurimet publike në BE paraqesin një treg të konsiderueshëm. Sipas vlerësimeve të Komisionit Evropian vlera e përgjithshme e prokurimeve publike paraqet 16 % nga prodhimi kombëtar bruto i Bashkimit Evropian.

Sistemi i prokurimeve publike bazohet në parime të përgjithshme të transparencës, trajtimit të barabartë, lirisë së konkurrencës tregtare dhe mosdiskriminimit. Qëllimi i legjislacionit evropian në këtë fushë është që të sigurohet ofruesve të shërbimeve, furnizuesve me mallra dhe kontraktuesve mundësia e konkurrencës në tenderët publikë në vende anëtare të BE-së dhe përforcimi i zhvillimit ekonomik dhe efikasitetit.



Negociatori



Shefi i GP



Sekretari i GP

Grupi i punës është formuar në gusht/shtator të vitit 2012. Negociator për këtë kapitull është **Vladimir Savkoviq**, doc. dr. në Fakultetin juridik të Universitetit të Malit të Zi, shef i grupit të punës është **Goran Nikolliq**, këshilltar në Ministrinë e Ekonomisë. Sekretar i grupit të punës është **Tatjana Tomiq**, nga MPJIE. Grupi i punës është i përbërë nga 27 anëtarë (17 nga institucionet shtetërore dhe 10 nga sektori civil).

Ky kapitull i referohet formimit dhe veprimtarisë së shoqërive tregtare në vende anëtare të Bashkimit Evropian. Përfshin dy pjesë: të drejtën e shoqërive tregtare në kuptimin e ngushtë, kontabilitetin dhe auditimin.

E drejta e shoqërive tregtare në kuptimin e ngushtë i referohet rregullave mbi formimin, regjistrimin, bashkimin e brendshëm dhe të jashtëm dhe ndarjen e shoqërive tregtare. Fusha e kontabilitetit dhe auditimit përfshin vendosjen e sistemit të kontrollit të cilësisë së punës së profesionit të auditimit dhe sistemit efikas të kontrollit publik, si dhe sistemit të shpalljes publike të raporteve vjetore financiare.

Qëllimi i harmonizimit të Ligjit malazez mbi shoqëritë tregtare me legjislacionin evropian dhe tendencat e reja në këtë fushë është krijimi i kushteve që të gjithë subjekteve ekonomike vendase do të ofrojnë mundësi të bëhen pjesëmarrës relevant dhe i barabartë i botës ekonomike bashkëkohore. Përveç këtyre, me harmonizimin e legjislacionit njëkohësisht tentohet të evitohet pasiguria ligjore që mund të paraqesë një pengesë të shtuar për veprimtarinë ekonomike dhe investimet.





Negociatori



Shefi i GP



Sekretari i GP

Grupi i punës është formuar në shtator të vitit 2012. Negociator për këtë kapitull është **Vladimir Savković**, doc. dr në Fakultetin juridik të Universitetit të Malit të Zi, shef i grupit të punës është **Novak Axhiq**, drejtor i Entit për pronësinë intelektuale. Sekretar i grupit të punës është **Marko Mrdak**, nga MPJIE. Grupi i punës është i përbërë nga 21 anëtarë (15 nga institucionet shtetërore dhe 6 nga sektori civil).

Pronësia intelektuale nënkupton të drejtat e autorit dhe të drejtat e ngjashme, si dhe të drejtat mbi pronësinë industriale.

E drejta e autorit i referohet të drejtës së autorit që të disponojë me veprat e veta letrare, shkencore ose artistike, si dhe me vepra nga fushëveprimet tjera të krijimtarisë. Qëllimi i rregullave evropiane në pikëpamje të mbrojtjes së të drejtave të autorit është përshtatja e rregullave kombëtare të vendeve anëtare për të krijuar mënyrën më të mirë për përcjelljen e zhvillimit teknologjik, por edhe të detyrimeve ndërkombëtare të pranuar në kuadër të Organizatës Botërore për pronësinë intelektuale.

Pronësia intelektuale përfshin të drejtat me të cilat prodhuesit i mbrojnë nga konkurrenca interesat e veta ekonomike, pozitën në treg dhe mjetet e investuara në kërkim, zhvillim dhe promovim të prodhimeve. Dizajni industrial mbron formën e re të jashtme ose pamjen e prodhimit, dhe përveç këtij masat e tjera mbrojtëse të aspekteve dhe funksioneve të veçanta të prodhimeve janë edhe patenta me të cilën mbrohet zgjidhja e re e një problemi teknik, si dhe vula e cila përdoret për të dalluar nga prodhimet e ngjashme që ekzistojnë në treg.

Trashëgimia juridike e Bashkimit Evropian përcakton pikënisjen e përbashkët për mbrojtje të dizajnit industrial dhe vendos një sistem të përbashkët për dizajnin industrial të Bashkimit (RCD) dhe vulën e Bashkimit (CTM).



Negociatori



Shefi i GP



Sekretari i GP


Grupi i punës është formuar në gusht/shtator të vitit 2012. Negociator për këtë kapitull është **Igor Noveliq**, sekretar i Ministrisë së ekonomisë, shef i grupit të punës është **Zoran Perishiq**, zëvendësministër i Ekonomisë. Sekretar i grupit të punës është **Marko Mrdak**, nga MPJIE. Grupi i punës është i përbërë nga 26 anëtarë (14 nga institucionet shtetërore dhe 12 nga sektori civil).

Trashëgimia juridike e BE-së që i referohet konkurrencës përfshin politikën e konkurrencës së tregut dhe kontrollin e asistencës shtetërore. Vendet anëtare të BE-së kanë akorduar rregulla të përbashkëta që u mundësojnë të gjithë pjesëmarrësve pozitën e barabartë në treg.

Rregullat e konkurrencës së tregut paraqesin bazën mbi të cilën është formuar ekonomia tregtare e një vendi. Qëllimi i saj është të ndihmojë tregun për të funksionuar sa më mirë në kushte të tregut që vlejnë njësoj për të gjithë pjesëmarrësit. Me këto rregulla është përcaktuar mbrojtja nga kartelet e ashtuquajtura – nga lidhja e marrëveshjeve të ndaluara mes ndërmarrësve që, për shembull, i shërbejnë akordimit të çmimeve, kufizimit të prodhimit, zhvillimit ose investimeve, ndarjes së ndërsjellë të tregut ose burimeve prej të cilave furnizohen.



Negociatori



Shefi i GP



Sekretari i GP

Grupi i punës është formuar në mars të vitit 2013. Negociator për këtë kapitull është **Nikolla Fabris**, zëvendësguvernator i Bankës Qendrore të Malit të Zi, shef i grupit të punës është **Ana Vllahoviq**, këshilltare e zëvendësguvernatorit të Bankës Qendrore të Malit të Zi. Sekretar i grupit të punës është **Zorka Kordiq**, nga MPJIE. Grupi i punës është i përbërë nga 35 anëtarë (21 nga institucionet shtetërore dhe 14 nga sektori civil).

Ky kapitull i referohet përputhshmërisë së rregullave në fushën bankare, të sigurimeve dhe risigurimit, fondeve të pensioneve nën përkrahje të punëdhënësit, tregut të kapitalit dhe infrastrukturës së tregjeve financiare, me trashëgiminë juridike të BE-s, por edhe zbatimin e tyre efikase nga ana e institucioneve kompetente mbikëqyrëse, çfarë ka si rezultat përfundimtar nxitjen dhe ruajtjen e stabilitetit financiar.

Ky kapitull përfshin katër fusha: 1. Veprime bankare dhe konglomeratet financiare, 2. Sigurimet dhe sigurimi pensionist nën përkrahje të punëdhënësit, 3. Letrat me vlerë tregtare dhe shërbimet investuese, dhe 4. infrastruktura e tregjeve financiare.


Për zbatimin e trashëgimisë juridike të BE-së në këtë fushë janë kompetentë Ministria e Financave, Banka Qendrore e Malit të Zi – BQMZ, Komisioni i letrave me vlerë – KLV, Agjencia për kontrollin e sigurimeve – AKS dhe Fondi për mbrojtjen e depozitave - FMD.



Negociatori



Shefi i GP



Sekretari i GP

Grupi i punës është formuar në nëntor të vitit 2012. Negociator për këtë kapitull është **Angjello Llojpur**, profesor i Universitetit të Malit të Zi, shef i grupit të punës është **Ruzhica Mishkoviq**, këshilltare në Ministrinë e shoqërisë së informacionit dhe mediat. Sekretari i grupit të punës është **Melita Rastoder**, nga MPJIE. Grupi i punës është i përbërë nga 39 anëtarë (23 nga institucionet shtetërore dhe 16 nga sektori civil).

Kapitulli Shoqëria e informacionit dhe mediat përbëjnë një tërësi të tre fushave: komunikimit elektronik, shërbimeve të shoqërisë së informacionit dhe politikës audio-vizuale.

Rregullat evropiane promovojnë dhe nxisin konkurrencën në treg, zhvillimin dhe qasjen sa më të gjerë të shërbimeve bashkëkohore, si dhe teknologjive, me theks tek interesat e përdoruesve të fundit të shërbimeve.

Çështjet kryesore në kuadër të fushës së komunikimeve elektronike janë: qasja e vëllimit të gjerë, standardizimi, interkoneksioni, tregu dhe analiza e tregut, shërbimet universale dhe të drejtat e përdoruesve, çështjet e privatësisë, digjitalizimi dhe politika e radio spektrave. Çështjet kryesore në kuadër të fushës së shërbimeve të shoqërisë së informacionit janë: siguria e informacionit, e-administrata, e-shëndetësia, e-nënshkrimi, sektori publik, e-tregtia. Çështjet kryesore në kuadër të fushës së politikës audio-vizuale janë: shërbimet mediave audio-vizuale, shërbimet publike radio difuze të Malit të Zi, mbrojtja e të miturve, trashëgimia e filmit, shumëllojshmëria/diversiteti kulturor.

Trashëgimia juridike e këtij kapitulli përfshin rregullat që mundësojnë funksionimin efikas të tregut të përbashkët në fushën e shërbimeve dhe rrjeteve telekomunikuese, si dhe promovimin, zhvillimin dhe qasjen më të gjerë të tyre. Qëllimi i BE-së është që përdoruesve t'u sigurojë shërbimet me çmime të volitshme (telefon, faks, qasja tek interneti, thirrjet urgjente falas), njëkohësisht duke stimuluar konkurrencën në treg dhe duke zvogëluar dominimet e monopolit që ende janë të pranishme për disa shërbime të veçanta (p.sh. qasja tek interneti i shpejtësisë së madhe). Prioriteti i BE-së është dhe parandalimi i "humnerës digjitale" mes rajoneve të pasura dhe atyre të varfra të BE-së në kuptimin e qasjes tek interneti.

Në fushën e politikës audio-vizuale, gjegjësisht mediave, theksi i posaçëm vihet tek mbrojtja e të miturve nga përmbajtjet jo të përshtatshme programore, si dhe tek rregullat mbi tele-tregtinë dhe shpalljet. Promovohen veprat evropiane audio-vizuale, si dhe veprat e prodhuesve të pavarur, jepen rekomandimet mbi pluralizmin në media, mbrojtjen e pasurisë së filmit, etj.



Negociatori



Shefi i GP



Sekretari i GP

Grupi i punës është formuar në tetor të vitit 2012. Negociator për këtë kapitull është **Danijella Stollica**, zëvendësministre e bujqësisë dhe zhvillimit rural, shefi i grupit të punës është **Kristina Llapçeviq**, epre e Departamentit për analiza ekonomike pranë Ministrisë së bujqësisë dhe zhvillimit rural. Sekretari i grupit të punës është **Vellimir Shlivançanin**, nga MPJIE. Grupi i punës është i përbërë nga 74 anëtarë (44 nga institucionet shtetërore dhe 30 nga sektori civil).

Politika e përbashkët bujqësore (PPB) është politika bujqësore e BE-s qëllimet e të cilës janë sigurimi i standardit jetësor të bujqve, sigurimi i furnizimit stabil dhe të sigurt me ushqim me çmime të qasshme për konsumatorët, duke ruajtur njëkohësisht zonat rurale.

Parimet kryesore mbi të cilat bazohet PPB:

- Tregu unik – Të gjitha vendet anëtare përbëjnë një treg unik dhe në këtë mënyrë për të gjitha vendet janë siguruar të njëjtat rregulla të shfaqjes, si në tregun unik, ashtu dhe në tregti me vende të treta;
- Prioriteti i Bashkimit Evropian është edhe evitimi i çrregullimeve në treg dhe vendosja e stabilitetit në furnizimin me prodhime bujqësore;
- Solidariteti financiar i referohet të gjitha vendeve anëtareve të BE-së, pa përjashtime. Ato marrin pjesë në mbulimin e shpenzimeve të PBP, por pjesëtimi i financimit nuk është i njëjtë për të gjitha vendet.



Negociatori



Shefi i GP



Sekretari i GP

Grupi i punës është formuar në shtator të vitit 2012. Negociator për këtë kapitull është **Danijella Stollica**, zëvendësministre e bujqësisë dhe zhvillimit rural, shef i grupit të punës është **Zorka Prleviq**, drejtore e Drejtorisë fitosanitare. Sekretar i grupit të punës është **Srgjan Qetkoviq**, nga MPJIE. Grupi i punës është i përbërë nga 55 anëtarë (20 nga institucionet shtetërore dhe 35 nga sektori civil).

Trashëgimia juridike në fushën e sigurisë së ushqimit, politikës veterinerë dhe kontrolleve fitosanitare për qëllim ka sigurimin e nivelit të lartë të mbrojtjes së shëndetit të konsumatorit, mbrojtjen e shëndetit dhe mirëqenien e kafshëve, mbrojtjen e bimëve të shëndoshtë dhe njëkohësisht parandalimi i përhapjes së sëmundjeve ngjitëse dhe parazitare dhe organizmave të dëmshme për bimët në Mal të Zi dhe njëkohësisht në Bashkimin Evropian.

BE e zbaton një qasje integrale “nga fusha deri tek tavolina”, që përbëhet nga tri pjesë që ndërthuren:

- siguria e ushqimit: rregullat e higjienës në prodhimtari, përpunimin dhe qarkullimin e ushqimeve dhe ushqimeve për kafshët, kontrolli zyrtar dhe mekanizmat për vendosjen e sigurisë së ushqimit;
- politika veterinerë: rregullat mbi qarkullimin e kafshëve dhe prodhimeve kafshore, shëndetin e kafshëve, kontrollin zyrtar të importit të prodhimeve nga vendet e treta, si dhe përcjellja e lëvizjes së kafshëve;
- kontrolli fitosanitar: rregullat mbi kontrollin e organizmave të dëmshme në bimë dhe materialin bimor, futja në treg e mjeteve për mbrojtjen e bimëve, farërave dhe materialit për mbjellje, kontrolli i rezidualit të pesticideve në prodhimet me origjinë bimorë.

Gjithashtu, ky kapitull përfshin rregullat që i referohen organizmave gjenetike të modifikuara.



Negociatori



Shefi i GP



Sekretari i GP

Grupi i punës është formuar në shkurt të vitit 2013. Negociator për këtë kapitull është **Danijella Stollica**, zëvendësministre e bujqësisë dhe zhvillimit rural, shefi i grupit të punës është **Aleksandër Joksimoviq**, drejtor i Institutit për biologjinë e detit. Sekretar i grupit të punës është **Vellimir Shlivançanin**, nga MPJIE. Grupi i punës është i përbërë nga 42 anëtarë (24 nga institucionet shtetërore dhe 18 nga sektori civil).

Peshkimi është një degë e rëndësishme e ekonomisë dhe duke e shikuar historikisht, ai parqet një veprimtari që është e pranishme shumë gjatë në vendet e BE-së. Me Politikën e përbashkët të peshkimit (PPP) janë rregulluar shfrytëzimi racional i resurseve përtëritëse si dhe çështjet e rregullimit të tregut me prodhime të peshkimit, politikat strukturale, mbikëqyrja dhe kontrolli dhe bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën e peshkimit.

Politika e përbashkët e peshkimit të BE-s përfshin çështjet e shfrytëzimit dhe të administrimit të pasurive të peshkore, çështjet e rregullimit të tregut me prodhime të peshkimit, çështjet e politikave strukturale, mbikëqyrjen dhe kontrollin si dhe bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e peshkimit.

Politika e përbashkët e peshkimit në fillim ishte pjesë e Politikës së përbashkët bujqësore (PPB), dhe në favor të ndarjes së saj në një politikë të posaçme ka kontribuar hyrja në BE e vendeve me flota të konsiderueshme peshkuese dhe resurse të mëdha detare, si dhe nevoja e zgjidhjes së problemeve të reja specifike, siç është ruajtja e resurseve të peshkut.



Negociatori



Shefi i GP



Sekretari i GP

Grupi i punës është formuar në prill të vitit 2013. Negociator për këtë kapitull është **Angellina Zhivkoviq**, u.d. së drejtores së përgjithshme për akset rrugore shtetërore pranë Ministrisë së komunikacionit dhe të detarisë, shefi i grupit të punës është **Zoran Radonjic**, sekretar i Ministrisë së komunikacionit dhe të detarisë. Sekretar i grupit të punës është **Amina Bajroviq**, nga MPJIE. Grupi i punës është i përbërë nga 52 anëtarë (34 nga institucionet shtetërore dhe 18 nga sektori civil).

Suaza ligjore e politikës së komunikacionit të BE-së mundëson vendosjen e sistemit efikas të transportit të mallrave dhe të udhëtarëve brenda Bashkimit Evropian dhe në nivelin ndërkombëtar, çfarë kontribuon zvogëlimin të kufizimeve mes vendeve. Politika e komunikacionit ka për qëllim plotësimin e nevojës për lëvizjen e qytetarëve dhe të mallrave brenda BE-së, çfarë sigurohet me komunikacion më të sigurt, përmirësimin e cilësisë së shërbimeve në komunikacion, rritjen e efikasitetit të transportit dhe infrastrukturës të komunikacionit përmes sistemeve transportuese inteligjente dhe informatike. Rregullat e BE-së nga fusha e komunikacionit përkufizojnë standardet për zvogëlimin e ndikimit të dëmshëm të komunikacionit në mjedisin jetësor, si dhe mbrojtjen më efektive të të drejtave të udhëtarëve dhe zbatimin e legjislationit social.





Negociatori



Shefi i GP



Sekretari i GP

Grupi i punës është formuar në shkurt të vitit 2013. Negociator për këtë kapitull është **Angellina Zhivkoviq**, u.d. së drejtores së përgjithshme për akset rrugore shtetërore pranë Ministrisë së komunikacionit dhe të detarisë, shefi i grupit të punës është **Dragica Sekulliq**, zëvendësministre e Ekonomisë. Sekretar i grupit të punës është **Sanja Radoviq**, nga MPJIE. Grupi i punës është i përbërë nga 26 anëtarë (11 nga institucionet shtetërore dhe 15 nga sektori civil).

Qëllimet e politikës energjetike të BE-së janë konkurrenca, siguria e furnizimit dhe qëndrueshmëria.

Suaza ligjore në fushën e energjetikës është përbërë nga rregullat dhe politikat pikësëpari në pikëpamje të konkurrencës dhe asistencës shtetërore, duke përfshirë edhe sektorin e qymyrit, kushtet për qasje të barabartë resurseve të prospektimit, kërkimet dhe prodhimtarinë në sektorin e naftës dhe gazit, tregun energjetik të brendshëm (hapjen e tregut të energjisë elektrike dhe të gazit), promovimin e burimeve përtëritëse të energjisë dhe efikasitetit energjetik, energjinë bërthamore dhe sigurinë bërthamore dhe mbrojtjen nga rrezatimi. Sa i përket marrëveshjeve ndërkombëtare, kapitulli përmban Marrëveshjen mbi Kartën Energjetike dhe instrumentet e ngjashme.



Negociatori



Shefi i GP



Sekretari i GP

Grupi i punës është formuar në mars të vitit 2013. Negociator për këtë kapitull është **Nikolla Vukiqeviq**, drejtor i përgjithshëm për buxhetin në Ministrinë e Financave, shef i grupit të punës është **Novo Radoviq**, drejtor i përgjithshëm për sistemin tatimor dhe doganor në Ministrinë e Financave. Sekretar i grupit të punës është **Gjorgje Jankoviq**, nga MPJIE. Grupi i punës është i përbërë nga 39 anëtarë (31 nga institucionet shtetërore dhe 8 nga sektori civil).

Harmonizimi tatimor paraqet bashkërenditjen e sistemeve tatimore të vendeve anëtare të BE-së për shkak të evitimit të masave tatimore kombëtare që mund të ndikojnë negativisht tek funksionimi i tregut të brendshëm të BE-së.

Çdo vend anëtar ka të drejtë të mbajë sistemin e vet tatimor më në fund edhe të vendosë format e reja të tatimit, me detyrë që disa nga pjesët e tyre t'i përshtatin me rregullat evropiane. Në fushën e tatimeve akoma zbatohet vendimmarrja me konsensus mes vendeve anëtare. Megjithatë, ekzistojnë disa rregulla të përbashkëta që, në frymën e respektimit të konkurrencës së tregut, rregullojnë shkallët minimale tatimore (TVSH, akcizat).

Dallimet në sistemet tatimore të vendeve anëtare, si dhe në politika tatimore kombëtare që udhëheqin, shkaktojnë diskriminimin në pikëpamje të investimeve mes vendeve anëtare, ashtu që harmonizimi i përcaktuar tatimor është bërë një kusht i domosdoshëm i funksionimit të tregut unik të BE-së. Qëllimi i BE-së nuk është të standardizojë sistemet kombëtare tatimore, por të sigurojë që ata të jenë të përshtatshëm jo vetëm njëri me tjetrin, por edhe me qëllimet e përcaktuara në Traktatin mbi themelimin e BE-s. Kjo mund të realizohet përmes bashkërenditjes, udhëheqjes së politikës së përbashkët dhe aktiviteteve në fusha të caktuara, përputhjes së legjislacionit kombëtar përmes rregulloreve dhe direktivave, gjitha këto në përputhje me Traktatin mbi themelimin e BE-s.

*\*Shefi i mëparshëm i Grupit të punës, nga formimi deri në korrik të vitit 2014 ishte Tatjana Boshkoviq, këshilltare në Ministrinë e Financave.*



Negociatori



Shefi i GP



Sekretari i GP

Grupi i punës është formuar në dhjetor të vitit 2012. Negociator për këtë kapitull është **Nikolla Fabris**, zëvendësgubernator i Bankës Qendrore të Malit të Zi, shef i grupit të punës është **Millica Killibarda**, drejtore e Drejtorisë për politikë monetare dhe kërkime fiskale në Bankën Qendrore të Malit të Zi. Sekretar i grupit të punës është **Zorka Kordiq**, nga MPJIE. Grupi i punës është i përbërë nga 41 anëtarë (35 nga institucionet shtetërore dhe 6 nga sektori civil).

Trashëgimia juridike e Bashkimit Evropian në fushën e politikës ekonomike dhe monetare i referohet rregullave të posaçme me të cilat kërkohet pavarësia e bankave qendrore në vende anëtare, ndalohet financimi i sektorit publik nga ana e bankës qendrore si dhe qasja e privilegjuar e sektorit publik në institucione financiare dhe respektimi i rregullave në fushën e politikës fiskale dhe kontrollit.

Detyra e të gjitha vendeve anëtare të BE-së është që politikën ekonomie ta trajtojnë si një interes të përbashkët dhe në mënyrë të ndërsjellë të bashkërendisin vazhdimisht politikat ekonomike kombëtare, si dhe të realizojnë buxhetin e ekuilibruar kombëtar.

Harmonizimi i politikave ekonomike nënkupton dhe planifikimin e përbashkët të integritimit të ekonomisë, nxitjen e zhvillimit ekonomik, sigurimin e vendeve të punës dhe konkurrencës së ekonomisë evropiane si një tërësie në nivelin global.

Për tu anëtarësuar në Bashkimin Evropian dhe Monetar, vendet kandidatë duhet të plotësojnë kushtet që janë të përkufizuara me Traktatin e Mاستrihtit të vitit 1992:

- Çmimet stabile: inflacioni mund të jetë më së shumti deri në 1,5% më lart se shkalla e inflacionit të tri vendeve me shkallë më të ulët të inflacionit;
- Financat publike stabile: deficiti buxhetor nuk duhet të jetë më i lartë se 3% i PBB; borxhi publik nuk duhet të jetë më i lartë se 60% i PBB-s.

Përpos kriterëve ekonomike, të gjitha vendet duhet të plotësojnë kriteret institucionale: të harmonizojnë rregullat me trashëgiminë juridike të BE-së dhe të sigurojnë pavarësinë e bankës qendrore (pavarësia funksionale, institucionale dhe personale).

\*Shefi i mëparshëm i Grupit të punës, nga formimi deri në shtator të vitit 2013 ishte Zorica Kaleziq, këshilltare e guvernatorit të Bankës Qendrore.



Negociatori



Shefi i GP



Sekretari i GP

Grupi i punës është formuar në prill të vitit 2012. Negociator për këtë kapitull është **Nikolla Fabris**, zëvendësguvernator i Bankës Qendrore të Malit të Zi, shef i grupit të punës është **Gordana Radojeviq**, drejtore e Entit të statistikës. Sekretar i grupit të punës është **Ana Tomkoviq**, nga MPJIE. Grupi i punës është i përbërë nga 101 anëtarë (89 nga institucionet shtetërore dhe 12 nga sektori civil).

Harmonizimi me trashëgiminë juridike në kuadër të këtij kapitulli është me rëndësi të madhe, jo vetëm për fushën e statistikës, por edhe për kapituj të tjerë të negociatave, sepse përmes statistikës përcillet përparimi në fushat e tjera të negociatave.

Qëllimi i negociatave brenda këtij kapitulli është harmonizimi i statistikës zyrtare me standardet dhe metodologjitë evropiane përmes krijimit të sistemit unik të harmonizuar metodologjik evropian i cili me minimumin e shpenzimeve të resurseve njerëzore dhe financiare dërgon të dhënat më cilësore përdoruesve në afat më të shkurtër të mundshëm dhe në mënyrë më të mirë.

Nga cilësia dhe qasshmëria e të dhënave statistikore varet dhe cilësia e bazës mbi të cilën themelohet politika zyrtare e një vendi. Bartësit kryesorë të statistikës zyrtare shtetërore janë entet statistikore që janë përgjegjës për bashkërenditjen e sistemit statistikor kombëtar. Në nivelin evropian këtë funksion e kryen Zyra statistikore e Bashkimit Evropian – Eurostat, që grumbullon dhe shpall të dhëna statistikore. Statistika evropiane është e bazuar mbi parimet e pavarësisë, besueshmërisë, konfidencës, paanësisë dhe objektivitetit çfarë nxit vendet anëtare të përmirësojnë standardet mbi të cilat bazohet statistika zyrtare.



Negociatori



Shefi i GP



Sekretari i GP

Grupi i punës është formuar në dhjetor të vitit 2012. Negociator për këtë kapitull është **Arijana Nikolliq**, drejtoreshë për tregun e punës dhe punësim pranë Ministrisë së punës dhe përkujdesjes sociale, shefi i grupit të punës është **Slobodan Fillipoviq**, drejtor i Drejtorisë së punës pranë Ministrisë së punës dhe përkujdesjes sociale. Sekretar i grupit të punës është **Dragana Garbin**, nga MPJIE. Grupi i punës është i përbërë nga 65 anëtarë (54 nga institucionet shtetërore dhe 11 nga sektori civil).

Politika e punësimit paraqet qëllimet strategjike të BE-së në arritjen e punësimit të plotë, kushteve të mira të punës, produktivitetit të lartë dhe kohezionit social në përputhje me politikën e "fleksisigurisë" që do të thotë kombinimin e fleksibilitetit dhe sigurisë së tregut të fuqisë punëtore.

Trashëgimia juridike në këtë kapitull përfshin standardet minimale nga fusha e së drejtës së punës, trajtimit të barabartë të meshkujve dhe femrave në çështje të punësimit dhe sigurisë sociale, shëndetësisë dhe sigurisë në punë. Përveç këtyre, janë hartuar rregullat e posaçme detyruese në pikëpamje të ndalimit të diskriminimit në bazë të racës, përkatësisë etnike, besimit, invaliditetit, moshës ose orientimit gjinor/sekual.

Fondi social evropian (FSE) është instrument kryesor për zbatimin e politikës strategjike të BE-së në fushën e punësimit. Fondi është themeluar në vitin 1957. Nga Fondi financohen masat për ngritjen e punësimit në vende anëtare dhe rajone të BE-së, veçanërisht në ato më pak të zhvilluara.

Evropa 2020 është strategjia e BE-së dhe paraqet një vizion se si të sigurohen vendet e punës të reja dhe të sigurta dhe jetesa më e mirë për qytetarët. Qëllimi i kësaj strategjie është zhvillimi ekonomik i bazuar mbi njohuri (duke ruajtur mjedisin jetësor), nivel të lartë të punësimit, produktivitet dhe kohezion social.

*\*Shefi i mëparshëm i Grupit të punës, nga formimi deri në qershor të vitit 2014 ishte Vesna Simoviq, zëvendësministre e punës dhe përkujdesjes sociale.*



Negociatori



Shefi i GP



Sekretari i GP

Grupi i punues është formuar në shtator të vitit 2012. Negociator për këtë kapitull është **Vladimir Savković**, docent dr. në Fakultetin juridik të Universitetit të Malit të Zi, shef i grupit të punës është **Dragan Kujović**, zëvendësministër i Ekonomisë. Sekretar i grupit të punës është **Vladana Mitrović**, nga MPJIE. Grupi i punës është i përbërë nga 47 anëtarë (36 nga institucionet shtetërore dhe 11 nga sektori civil).

Qëllimi i politikës së ndërmarrjeve dhe të industrisë së Bashkimit Evropian është krijimi i ambientit të volitshëm për prodhuesit dhe ndërmarrësit përmes ofrimit të mbështetjes që të jenë konkurrent me prodhime të veta dhe që të kenë mundësi të veprojnë në kushte të drejta dhe të barabarta në Evropë dhe në të gjithë botën.

Objekti i negociatave brenda këtij kapitulli janë politika industriale, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) dhe politika e ndërmarrjeve, programet e Bashkimit, Direktiva mbi luftën kundër pagesave të vonuara, instrumentet financiare të asistencës, industria turistike, industria ajrore dhe detare, ndërtimtaria, industria e drurit, industria e çelikut, metaleve dhe lëndëve të tjera.

Politika industriale e BE-së tenton që të promovojë strategjitë industriale të cilat do të ndikojnë tek ngritja e konkurrencës dhe përshpejtimit të përshtatjes për ndryshime strukturale, tek nxitja e krijimit të ambientit të volitshëm për krijimtari ekonomike dhe rritje anëmbanë BE-së, si dhe tek investimet e brendshme dhe të jashtme. Gjithashtu, ajo ka për qëllim përmirësimin e klimës gjithëpërfshirëse për biznesin në të cilën funksionojnë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, çfarë përfshin edhe privatizimin dhe ristrukturimin.



Negociatori



Shefi i GP



Sekretari i GP

Grupi i punës është formuar në prill të vitit 2013. Negociator për këtë kapitull është **Angellina Zhivkoviq**, u.d. së drejtorës së përgjithshme për akset rrugore shtetërore në Ministrinë e komunikacionit dhe detarisë, shef i grupit të punës është **Zoran Vukashinoviq**, eprori i Departamentit për punë normative - juridike në Ministrinë e komunikacionit dhe detarisë. Sekretar i grupit të punës është **Amina Bajroviq**, nga MPJIE. Grupi i punës është i përbërë nga 13 anëtarë (8 nga institucionet shtetërore dhe 5 nga sektori civil).

Rrjetet ndërvropiane (RRNE) paraqesin boshtin e zhvillimit të tregut të brendshëm të BE-së. Qëllimi i këtij kapitulli është krijimi i rrjetit rrugor, energjetik dhe telekomunikues që do të ndërlidhë të gjitha vendet anëtare të BE-së, me mundësi që të kyçen edhe vendet e treta.

Pa infrastrukturë bashkëkohore që do të ndërlidhte rrjetet e ndryshme rajonale dhe kombëtare nuk është e mundur vendosja e qarkullimit të lirë të udhëtarëve, të mallrave dhe të shërbimeve çfarë paraqet një element të rëndësishëm për realizimin e kohezionit ekonomik dhe social të Bashkimit Evropian.

Ky kapitull përfshin rrjetin rrugor trans-evropian, rrjetin energjetik trans-evropian dhe rrjetin telekomunikues trans-evropian.





Negociatori



Shefi i GP



Sekretari i GP

Grupi i punës është formuar në tetor të vitit 2012. Negociator për këtë kapitull është sekretari shtetëror për integrimin evropian ambasador **Aleksandër Andrija Pejoviq**, shefi i grupit të punës është **Ivana Petriçeviq**, drejtore e përgjithshme e Drejtorisë së përgjithshme për bashkërenditjen e programeve të asistencës së BE-së. Sekretar i grupit të punës është **Bojan Vujoviq**, nga MPJIE. Grupi i punës është i përbërë nga 35 anëtarë (30 nga institucionet shtetërore dhe 5 nga sektori civil).

Politika rajonale e Bashkimit Evropian nënkupton asistencën financiare të vendeve anëtare dhe rajoneve përmes implementimit të projekteve qëllimi i të cilave është përforcimi i kohezionit ekonomik, shoqëror dhe territorial, me vëmendje të posaçme tek: (1) zvogëlimi i dallimeve mes rajoneve të BE-s me qëllim të përforcimit të kohezionit ekonomik dhe shoqëror; (2) përforcimi i konkurrencës rajonale me qëllim që Bashkimi, si tërësi, të mbetet konkurrent në tregjet botërore; dhe (3) bashkëpunimi territorial evropian me qëllim të promovimit të bashkëpunimit mes rajoneve të BE-së.

Ky kapitull përmban rregulloret suazë që përkufizojnë rregullat për përgatitjen dhe miratimin e programeve operative zbatimi i të cilëve financohet nga fondet strukturore dhe investuese evropiane (fondet SIE), do të thotë Fondit evropian për zhvillimin rajonal dhe Fondit evropian social dhe – për disa vende anëtare – programit të Fondit kohezion me respektim të organizimit territorial të çdo vendi anëtar.

Në periudhën 2007 – 2013, për vendet anëtare të BE-së përmes Fondit evropian për zhvillimin rajonal, Fondit evropian social dhe Fondit kohezion janë përcaktuar afro 338,8 miliardë euro. Mjetet nga këto fonde do të jenë të qasshme për Malin e Zi pas anëtarësimit në BE.





Negociatori



Shefi i GP



Sekretari i GP

Grupi i punës është formuar në mars të vitit 2012. Negociator për këtë kapitull është **Svetlana Rajković**, drejtore e përgjithshme për bashkëpunimin juridik ndërkombëtar dhe integrimin evropian në Ministrinë e Drejtësisë, shef i grupit të punës është **Branka Llakoçeviq**, zëvendësministre e Drejtësisë. Sekretar i grupit të punës është **Violetë Berishaj**, nga MPJIE. Grupi i punës është i përbërë nga 47 anëtarë (41 nga institucionet shtetërore dhe 6 nga sektori civil).

Qëllimi i këtij kapitulli është krijimi i parakushteve për gjyqësorin e pavarur dhe të paanshëm, me kapacitete administrative për mbrojtjen e sundimit të së drejtës.

Ky kapitull i trashëgimisë juridike përbëhet nga fusha e gjyqësorit, antikorrupsioni, të drejtat themelore dhe të drejtat e qytetarëve të BE-s. Përveç nevojës për harmonizimin e plotë të legjislacionit kombëtar me trashëgiminë juridike të BE-s, nevojitet që vendi kandidat të arrijë rezultatet e dukshme dhe të matshme në zbatimin e atyre ligjeve.

Trashëgimi juridike nga fusha e antikorrupsionit përbëhet nga një gamë konventash të KB dhe Këshillit të Evropës, si dhe vendimeve dhe rekomandimeve të Këshillit Evropian. Vendi kandidat duhet plotësisht të harmonizohet me trashëgiminë juridike në këtë fushë, por edhe të tregojë gatishmërinë për të arritur rezultatet e matshme si në parandalimin ashtu dhe në luftën kundër korrupsionit.

Fusha e të drejtave themelore përmban një gamë konventash, protokollesh, kartash dhe deklaratash që vendi kandidat duhet të përfshijë në sistemin e vet juridik dhe njëkohësisht të sigurojë edhe zbatimin efikas.

Të drejtat e qytetarëve të BE-së përfshijnë kushtet për realizmin e të drejtave të shtetasve të vendeve anëtare të BE-së. Këtu përfshihen e drejta e votimit dhe kandidaturës për zgjedhje lokale, e drejta e vendosjes së lirshme në territorin e BE-së dhe mbrojtja diplomatike e konsullore. Shumicën e trashëgimisë juridike nga kjo fushë e përbëjnë vendimet dhe direktivat që kryesisht hyjnë në fuqi në ditën e hyrjes në BE.



Negociatori



Shefi i GP



Sekretari i GP

Grupi i punës është formuar në mars të vitit 2012. Negociator për këtë kapitull është **Svetlana Rajković**, drejtore e përgjithshme për bashkëpunimin juridik ndërkombëtar dhe integrimin evropian në Ministrinë e Drejtësisë, shef i grupit të punës është **Mira Cerović**, këshilltare në Ministrinë e Brendshme. Sekretar i grupit të punës është **Millosh Radonjić**, nga MPJIE. Grupi i punës është i përbërë nga 44 anëtarë (42 nga institucionet shtetërore dhe 2 nga sektori civil).

Qëllimi kryesor i realizimit të të gjitha aktiviteteve në kuadër të këtij kapitulli është që të mundësohet lëvizja e lirë e njerëzve, duke garantuar sigurinë e tyre.

Ky kapitull i trashëgimisë juridike përmban disa nënfusha: migracionet, azilin, politikën e vizave, kufijtë e jashtëm dhe Shengenin, bashkëpunimin gjyqësor në çështje civile dhe penale, bashkëpunimin policor dhe luftën kundër krimit të organizuar, luftën kundër terrorizmit, bashkëpunimin në fushën e drogave, bashkëpunimin doganor dhe falsifikimin e euros.

*\*Shefi i mëparshëm i grupit të punës, nga formimi deri në qershor 2014. ka qenë Dragan Pejanović, sekretar i Ministrisë së Punëve të Brendshme.*



Negociatori



Shefi i GP



Sekretari i GP

Grupi i punës është formuar në korrik të vitit 2012. Negociator për këtë kapitull është **Angjello Llojpur**, profesor në Universitetin e Malit të Zi, shef i grupit të punës është **Smilana Prelleviq**, sekretare e Ministrisë së Shkencës. Sekretar i grupit të punës është **Marko Mrdak**, nga MPJIE. Grupi i punës është i përbërë nga 26 anëtarë (8 nga institucionet shtetërore dhe 18 nga sektori civil).

Bashkimi Evropian i konsideron si të rëndësishme shkencën dhe kërkimin, sepse këto fusha paraqesin një nga elementet më të rëndësishme të zhvillimit të çdo vendit. Njohuritë, si resursi më i rëndësishëm intelektual, gjatë kohës bëhet edhe më i rëndësishëm, kurse vendosja e sistemit shkencor stabil bëhet baza e shoqërisë moderne dhe nxitësi i avancimit të standardit të jetës.


Me strategji dhe programe të veta, BE ka siguruar kushtet cilësore për zhvillimin e veprimtarisë shkencore – kërkimore, çfarë, falë qasjes themelore shkencore dhe inovacioneve, i përgjigjet zhvillimit ekonomik. Për t'i kushtuar vëmendjen e posaçme në të ardhmen idesë kryesore të Strategjisë së Lisbonës dhe për ta bërë BE-në një ekonomi më konkurruese dhe më dinamike botërore, vendet anëtare kanë vendosur të ngrenë investimet në shkencë dhe në kërkim në 3 % të PBB-së dhe në mënyrë të tillë të nxisin indirekte konkurrencën dhe ngritjen e ekonomive kombëtare.



Negociatori



Shefi i GP



Sekretari i GP

Grupi i punës është formuar në korrik të vitit 2012. Negociator për këtë kapitull është **Angjellko Llojpur**, profesor në Universitetin e Malit të Zi, shef i grupit të punës është **Mubera Kurpejoviq**, zëvendësministre e arsimit dhe sportit. Sekretar i grupit të punës është **Mellita Rastoder**, nga MPJIE. Grupi i punës është i përbërë nga 41 anëtarë (18 nga institucionet shtetërore dhe 23 nga sektori civil).

Ky kapitull përfshin fushat e arsimit dhe trajnimit, të rinjve dhe të sportit, qasjes arsimit, programet dhe instrumentet e tjera të BE-së.

Fushat e arsimit dhe të kulturës janë nën kompetenca të vendeve anëtare. Bashkimi Evropian përmes mekanizmave në dispozicion i kontribuon zhvillimit të arsimit dhe lëvizshmërisë.

BE ndërmer masa konkrete që arsimit të bëhet pjesë e strategjisë së punësimit dhe për t'u bërë BE-ja qendra botërore e njohurive. BE promovon ruajtjen e pasurive kulturore me vlera evropiane, u ofron ndihmë njerëzve nga fusha e kulturës për jetë dhe punë në vende të tjera evropiane, nxit qarkullimin e lirshëm të prodhimeve dhe veprave kulturore dhe artistike anembanë BE-së dhe stimulon dialogun mes kulturave të ndryshme.

BE synon drejt sigurimit të kushteve të barabarta për arritjen e njohurive të nevojshme për kycje në procese shoqërore, njëkohësisht duke u kujdesuar mbi shumëllojshmërinë/diversitetin kombëtar, rajonal, kulturor dhe gjuhësor, sovranitetin e politikave arsimore të vendeve anëtare, si dhe për nxitje të bashkëpunimit mes vendeve anëtare.



Negociatori



Shefi i GP



Sekretari i GP


Grupi i punës është formuar në janar të vitit 2013. Negociator për këtë kapitull është **Dalliborka Pejoviq**, sekretare shtetërore në Ministri të zhvillimit të qëndrueshëm dhe turizmit, shef i grupit të punës është **Ivana Vojinoviq**, drejtore e përgjithshme e Drejtorisë së mjedisit jetësor dhe ndryshimeve klimatike në Ministri të zhvillimit të qëndrueshëm dhe turizmit. Sekretar i grupit të punës është **Sanja Radoviq**, nga MPJIE. Grupi i punës është i përbërë nga 61 anëtarë (50 nga institucionet shtetërore dhe 11 nga sektori civil).

Politikat e BE-së në fushën e mjedisit dhe ndryshimeve klimatike kanë për qëllim promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm, kalimin në ekonomi me emision të ulët të dyoksidit të karbonit dhe shfrytëzimin efikas të resurseve dhe mbrojtjen e mjedisit për gjenerata të sotshme dhe të ardhshme.

Trashëgimia juridike përfshin legjislacionin horizontal, cilësinë e ajrit, ndryshimet klimatike, administrimin e mbetjeve, administrimin e ujërave, mbrojtjen e natyrës, ndotjen industriale, mjetet kimike, zhurmën dhe mbrojtjen civile. Qëllimet e mbrojtjes së mjedisit janë mbrojtja e ruajtjes së shëndetit dhe jetës së njerëzve, cilësisë së ekosistemeve, mbrojtja specieve bimore dhe kafshore dhe pasurive kulturore krijuesi i të cilave është njeriu, ruajtja e ekuilibrit dhe stabilitetit ekologjik të natyrës, shfrytëzimi racional dhe adekuat i resurseve natyrore. Negociatat në këtë fushë janë rast i mirë për avancim të mbrojtjes së mjedisit si parakushtit të domosdoshëm për zbatimin e parimeve dhe standardeve të zhvillimit të qëndrueshëm.



Negociatori



Shefi i GP



Sekretari i GP

Grupi i punës është formuar në janar të vitit 2013. Negociator për këtë kapitull është **Dalliborka Pejoviq**, sekretare shtetërore në Ministrinë e zhvillimit të qëndrueshëm dhe turizmit, shefi i grupit të punës është **Rada Markoviq**, zëvendës drejtore e Drejtorisë për punë inspektuese. Sekretar i grupit të punës është **Mellita Rastoder**, nga MPJIE. Grupi i punës është i përbërë nga 42 anëtarë (30 nga institucionet shtetërore dhe 12 nga sektori civil).

Ky kapitull shqyrton temat dhe çështjet të ndara në dy pjesë: mbrojtja e konsumatorit dhe mbrojtja e shëndetit. Mbrojtja e interesave ekonomike të konsumatorëve, informimi dhe edukimi i konsumatorëve, si dhe mbrojtja e efikase të tyre janë baza e politikës së mbrojtjes së konsumatorëve në Bashkimin Evropian.

Çështjet kryesore në fushën e sigurisë së prodhimeve janë: siguria e përgjithshme e prodhimeve, prodhimet mashtruese dhe shkëmbimi i shpejtë i informacioneve mbi prodhimet e rrezikshme. Çështjet kryesore në fushën e mbrojtjes së interesave ekonomike të konsumatorëve janë: lidhja e kontratave në distancë; kontratat e lidhura jashtë zyrave; dispozitat që janë në kundërshtim me parime të ndërgjegjes edhe ndershmërisë (dispozitat e padrejta në kontrata konsumuese); shitja e mallrave të përdorimit të gjerë dhe garancitë kërcënuese; vendosja e çmimeve të prodhimeve që janë të ofruar konsumatorëve; reklamimi mashtrues dhe komparativ; praktika jolojale komerciale; përdorimi i patundshmërisë e ndarë në kohë; prodhimet afatgjata për pushim, rishitje dhe shkëmbim; aranzhimet rrugore, aranzhimet e pushimeve dhe aranzhimet e udhëtimeve të organizuara; shitja në distancë; përgjegjësia për prodhimet që nuk funksionojnë; ndalimi gjyqësor dhe administrativ; kreditë e konsumit; bashkëpunimi mes organeve kompetente për mbrojtjen e konsumatorëve.

Mbrojtja e shëndetit i referohet harmonizimit të qasjes politikës së shëndetit publik mes vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, dhe realizohet përmes avancimit të shëndetit dhe kontrollit mbi realizimin e qëllimeve të politikës shëndetësore, përmes luftës kundër sëmurjeve ngjitëse, sëmundjeve të rralla dhe kancerit, parandalimit të varësisë dhe aksidenteve, si dhe sëmundjeve të lidhura me ndotjen e mjedisit. Gjithashtu, kjo nënfushë shqyrton çështjet e të drejtave të pacienteve në mbrojtjen shëndetësore ndërkuftare, shëndetin mental, të gjakut, indeve, qelizave dhe organeve, parandalimit të lëndimeve, sëmundjeve ngjitëse, sëmundjeve të rralla si dhe parandalimit të keqpërdorimit të alkoolit dhe drogave dhe kontrollin e duhanit.

Qëllimet e politikës së BE-së për mbrojtjen e shëndetit janë: harmonizimi i legjisllacionit që i referohet mbrojtjes shëndetësore brenda Bashkimit Evropian, mbrojtja e qytetarëve nga kërcënimet e shëndetit, promovimi i politikave që sjellin drejt stileve të shëndosha të jetës kontributi zvogëlimi të lajmërimit të sëmundjeve të mëdha në Bashkimin Evropian, kontributi zhvillimit të sistemeve më efikase shëndetësore, ofrimi i informacioneve shëndetësore, dhënia e të drejtave qytetarëve për të shprehur mendimet mbi çështjet shëndetësore.

Masat e politikës së përbashkët të BE-së përfshijnë rregullimin e përbashkët mes organizatave të konsumatorëve dhe të biznesit, dhe udhëzimet për praktika të mira, si dhe legjisllacionin që i referohet mbrojtjes së konsumatorëve.



Negociatori



Shefi i GP



Sekretari i GP

Grupi i punës është formuar në prill të vitit 2013. Negociator për këtë kapitull është **Nikolla Vukiqeviq**, drejtor i përgjithshëm për buxhet pranë Ministrisë së Financave, shef i grupit të punës është **Mitar Bajçeta**, këshilltar në Ministri të Financave. Sekretar i grupit të punës është **Gjorgje Jankoviq**, nga MPJIE. Grupi i punës është i përbërë nga 31 anëtarë (27 nga institucionet shtetërore dhe 4 nga sektori civil).

Bashkimi doganor paraqet zonën unike doganore të 28 vendeve anëtare të Bashkimit Evropian brenda të cilës zhvillohet tregtia e përgjithshme dhe qarkullimi i brendshëm i mallrave mes vendeve anëtare, pa formalitete doganore, gjegjësisht pa kontroll doganor mbi mallra dhe pa pagesë të detyrimeve doganore.

Qëllimet kryesore të Bashkimit doganor janë krijimi i zonës së tregtisë së lirë, përforcimi i marrëdhënieve ekonomike mes vendeve anëtare të BE-së, përshpejtimi i zhvillimit të aktiviteteve tregtare, ngritja e standardit jetësor dhe sigurimi i mundësive më të mira për punësim, ngritja e produktivitetit dhe arritja e stabilitetit financiar.



Negociatori



Shefi i GP



Sekretari i GP

Grupi i punës është formuar në prill të vitit 2013. Negociator për këtë kapitull është **Igor Noveliq**, sekretar i Ministrisë së Ekonomisë, shef i grupit të punës është **Goran Shqepanoviq**, zëvendësministër i ekonomisë. Sekretar i grupit të punës është **Jellena Llekoviq**, nga MPJIE. Grupi i punës është i përbërë nga 24 anëtarë (22 nga institucionet shtetërore dhe 2 nga sektori civil).

Ky kapitull përfshin të gjitha aspektet e veprimit të BE-së në planin ndërkombëtar, duke përfshirë edhe politikën e përbashkët tregtare, marrëveshjet bilaterale me vende të treta, si dhe politikën e zhvillimit dhe ndihmën humanitare.

Politika e përbashkët tregtare përfshin tregtinë me mallra dhe shërbime, aspektet komerciale të pronësisë intelektuale, investimet e huaja të drejtpërdrejta, politikën e eksportit, si dhe masat për mbrojtjen e tregtisë. Qëllimet e saj janë: kontributi zhvillimit të tregtisë botërore, ndërprerja graduale e kufizimeve në tregtinë ndërkombëtare dhe në investime të huaja të drejtpërdrejta, si dhe zvogëlimi i barrierave doganore dhe të tjera.

BE i ka lidhur kontratat e shumta me vende të treta, me organizata rajonale dhe ndërkombëtare. Deri tani ka nënshkruar më shumë se 200 kontrata të ndryshme mbi tregtinë e lirë. Përveç këtyre bashkimi doganor është vendosur me Turqi, Andorrë dhe San Marino. Marrëveshjet mbi partneritetet dhe bashkëpunim janë nënshkruar edhe me Rusinë.

Detyra e vendit që aderohet Bashkimit Evropian është që të sigurojë që të gjitha kontratat/ marrëveshjet mbi tregtinë e lirë, investimet dhe bashkëpunimin ekonomik të jenë të harmonizuar me trashëgiminë juridike të BE-së.

Kur bëhet fjalë mbi kërkesat në pikëpamje të politikës së zhvillimit dhe ndihmës humanitare, nga Mali i Zi pritet të harmonizojë legjislacionin brendshëm me trashëgiminë juridike të BE-së, me detyrime ndërkombëtare që i pranojnë vendet anëtare të BE-së dhe të sigurojë kapacitetet për pjesëmarrje në ndihmën zhvillimore dhe humanitare që është destinuar për vendet në zhvillim dhe vendeve që më së paku janë të zhvilluara.





Negociatori



Shefi i GP



Sekretari i GP

Grupi i punës është formuar në prill të vitit 2012. Negociator për këtë kapitull është sekretari shtetëror për integrimin evropian, ambasadori **Aleksandër Andrija Pejoviq**, shefi i grupit të punës është ambasadori **Vladimir Radulloviq**, sekretar shtetëror për çështje politike në Ministri të punëve të jashtme dhe integritimit evropian. Sekretar i grupit të punës është **Milena Shofranac**, nga MPJIE. Grupi i punës është i përbërë nga 35 anëtarë (29 nga institucionet shtetërore dhe 6 nga sektori civil).

Në kuadër të kësaj fushe shqyrtohen çështjet e raporteve të vendit kandidat me Bashkimin Evropian dhe institucionet e tij. Ky kapitull merret me çështjet e politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurisë, si dhe të politikës së përbashkët të sigurisë dhe të mbrojtjes së Bashkimit Evropian. Në fokus gjendet aderimi dhe harmonizimi i Malit të Zi me deklaratat dhe vendimet të Këshillit të Bashkimit Evropian dhe Përfaqësuesit të Lartë për politikën e jashtme të BE-së.

Në këtë kapitull negociohet mbi sistemin e përgjithshëm të sigurisë dhe të mbrojtjes, në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare. Ai përbehet nga disa nënfusha: Bashkëpunimi me organizata ndërkombëtare (posaçërisht Këshilli i Evropës dhe Organizata e Kombeve të Bashkuara), kontrolli i armatimit, Politika evropiane e sigurisë dhe e mbrojtjes, dialogu politik me BE-në, bashkëpunimi me NATO-n, lufta kundër terrorizmit.

Kapitulli Politika e jashtme, e sigurisë dhe e mbrojtjes nënkupton dhe rregullon pjesëmarrjen e vendit kandidat në misione dhe institucione ushtarako-mbrojtëse dhe organizata që janë me interes për Bashkimin Evropian. Në radhë të parë theksohet bashkëpunimi i vendit kandidat me NATO dhe pjesëmarrja në misione paqeruajtëse.

Gjithashtu, vendi kandidat për anëtarësim në BE duhet të ketë një sistem të zhvilluar të kontrollit të armatimit që bazohet mbi suazën normative të harmonizuar me trashëgiminë juridike të BE-së.



Negociatori



Shefi i GP



Sekretari i GP

Grupi i punës është formuar në prill të vitit 2013. Negociator për këtë kapitull është **Nikolla Vukiçeviq**, drejtor i përgjithshëm për buxhetin në Ministri të Financave, shef i grupit të punës është **Ana Krsmanoviq**, zëvendësministre e Financave. Sekretar i grupit të punës është **Aleksandër Nikçeviq**, nga MPJIE. Grupi i punës është i përbërë nga 24 anëtarë (20 nga institucionet shtetërore dhe 4 nga sektori civil).

Ky kapitull i referohet standardeve, metodave dhe parimeve të kontrollit të brendshëm financiar në sektorin publik dhe të kontrollit të shpenzimit të mjeteve nga fondet e BE-së të pranuar në nivelin ndërkombëtar dhe në pajtim me BE-në. Kontrolli financiar përfshin katër fusha kryesore: kontrolli financiar i brendshëm publik (PIFC), auditimi i jashtëm, mbrojtja e interesave financiare të BE-së dhe mbrojtja e euros nga falsifikimi.

Qëllimet kryesore të këtij kapitulli janë: stabiliteti financiar i vendeve anëtare, parandalimi i keqpërdorimit të mjeteve financiare, kontributi shpenzimit më efikas, më të suksesshëm dhe më të ndërgjegjshëm të të hollave nga buxheti i shtetit dhe BE-së, dhe paraqesin një mekanizëm të konsiderueshëm në luftë kundër korrupsionit.

Sistemi i kontrolleve financiare të brendshme kontribuon në avancimin e disiplinës dhe transparencën e përdorimit të mjeteve publike, mjeteve të BE-së, si dhe mbrojtjes së interesave financiare të BE-së.



Negociatori



Shefi i GP



Sekretari i GP

Grupi i punës është formuar në prill të vitit 2013. Negociator për këtë kapitull është **Nikolla Vukiqeviq**, drejtor i përgjithshëm për buxhetin në Ministrinë e Financave, shef i grupit të punës është **Miodrag Radonjia**, zëvendësministër i Financave. Sekretar i grupit të punës është **Vlladana Mitrovic**, nga MPJIE. Grupi i punës është i përbërë nga 26 anëtarë (22 nga institucionet shtetërore dhe 4 nga sektori civil).

Ky kapitull përfshin rregullat mbi mjetet e veta që paraqesin të ardhurat financiare të buxhetit të BE-së.

Që çdo vend anëtar i Bashkimit Evropian të gëzojë të drejtën e përdorimit të mjeteve nga buxheti i përbashkët i Bashkimit Evropian, duhet të ketë edhe detyrimin e pagesës për buxhetin. Buxheti i përbashkët mbushet nga tri lloje kryesore të ardhurash: mjetet e veta tradicionale (të ardhurat nga doganat), mjetet e veta sipas bazës së tatimit mbi vlerë të shtuar (TVSH), si dhe nga mjetet e veta nga pagesat e vendeve anëtare në bazë të të ardhurave kombëtare bruto (AKB).

Buxheti i BE-së financon një gamë shumë të madhe aktivitetesh, nga zhvillimi rural dhe mbrojtja e mjedisit deri tek kufijtë e jashtëm dhe avancimi i të drejtave të njeriut. Komisioni Evropian, Këshilli dhe Parlamenti kanë të drejtë të votës mbi lartësinë e buxhetit dhe mënyrës së shpërndarjes së tij. Megjithatë, Komisioni Evropian dhe vendet anëtare janë përgjegjës për shpenzimin e mjeteve nga buxheti.

EU ka ndarë 959,988 miliardë euro për periudhën 2014-2020.



Negociatori

Ky kapitull merret me pjesëmarrjen e vendit të ardhshëm, anëtar në punën e institucioneve të Bashkimit Evropian.

Kjo nënkupton përcaktimin e numrit të përfaqësuesve në institucione, numrin e votave dhe mënyrën e votimit në trupe të caktuara. Këtu, para të gjithave, nënkuptohet numri i votave në Këshillin Evropian dhe Këshillin e Ministrave të BE-së. Përcaktohet në mënyrë precize numri i votave që vendi i ardhshëm anëtar do të ketë kur vendoset brenda Këshillit në raste kur merren vendimet me shumicë të kualifikuar.

Me anëtarësimin e vet, çdo vend e ka mundësinë të fitojë edhe një komisionar në përbërje të Komisionit Evropian. Sa i përket Parlamentit Evropian, me anëtarësimin e vet vendi ka të drejtë që shtetasit e tij të zgjidhen dhe të votojnë për anëtarë të Parlamentit Evropian. Traktati i Lisbonës ka përcaktuar numrin e përgjithshëm të deputeteve të Parlamentit Evropian. Para çdo zgjedhjeje, Këshilli i BE-së përcakton se sa deputetë do të ketë çdo vend anëtar.

Pas aderimit, vendi i ri anëtar fiton të drejtën të emërojë gjyqtarin në Gjykatën e Bashkimit Evropian. Gjithashtu, guvernatorët e bankave qendrore të çdo vendi anëtar marrin pjesë në punën e Bankës Qendrore Evropiane. Përveç këtyre, çdo vend anëtar i ka përfaqësuesit e vet në Gjykatën Evropiane të Auditimit, Komitetin Evropian Ekonomik dhe Social, Komitetin e Rajoneve, etj.



Negociatori

Ky kapitull do të negociohet në fund të procesit. Ai përfshin të gjitha çështjet që lajmërohen gjatë negociatave, por që nuk janë të përfshira me ndonjë kapitull tjetër të trashëgimisë juridike.



## ZYRA PËR MBËSHTETJE TË KRYENEGOCIATORIT

Zyra e Kryenegociatorit i kryen punët nga fushëveprimi i: mbështetjes së realizimit të punëve dhe aktiviteteve ditore të Kryenegociatorit, organizimit dhe përcjelljes së takimeve të Kryenegociatorit me përfaqësuesit e brendshëm dhe të jashtëm brenda dhe jashtë vendit, përgatitjes së takimeve dhe vizitave të Kryenegociatorit, si dhe pjesëmarrjes në evenimente publike. Zyra bashkërendit punët me strukturën për negociata dhe subjektet e tjera relevante të procesit të aderimit. Pjesa e Zyrës së Kryenegociatorit, që veprimtarinë e vet e kryen në kuadër të Misionit të Malit të Zi pranë Bashkimit Evropian, kryesisht është e fokusuar në komunikimin me përfaqësuesit e institucioneve të Bashkimit Evropian, në radhë të parë të Komisionit Evropian dhe Këshillit, si dhe me përfaqësitë e përhershme të vendeve anëtare pranë BE-së. Zyra e Kryenegociatorit në Misionin e Malit të Zi pranë BE-së paraqet kanalin e komunikimit të strukturës për negociata (në planin operativ të negociatorëve, shefave dhe sekretarëve të grupeve punuese për përgatitje të negociatave mbi kapituj) me Komisionin Evropian. Është përgjegjëse për bashkërenditjen e dorëzimit të materialeve dhe dokumenteve të procesit të negociatave në të dy drejtime mes strukturës për negociata dhe BE-së.

Zyra e Kryenegociatorit ka nëntë anëtarë, prej të cilëve shtatë janë në Podgoricë dhe dy në Bruksel. Punën e saj e udhëhiq shefi i Zyrës.

## SEKRETARIATI I GRUPIT NEGOCIATOR

Sekretariati i Grupit të negocimit është përgjegjës për bashkërenditjen e punëve që rrjedhin nga negociatat mbi aderim të Malit të Zi në Bashkimin Evropian, përgatitjen e pamjes analitike të harmonizimit të legjislacionit të Malit të Zi me trashëgiminë juridike të BE-së; për hartimin e raporteve gjatë negociatave, përgatitjen teknike për punën e grupeve punuese për negociata sipas kapitujve të caktuar, përgatitjen teknike të propozimit të pozitivave për negociata, përgatitjen e takimeve të delegacionit shtetëror dhe Grupit të negocimit dhe bashkërenditjen e bazës elektronike të të dhënave për përcjellje të negociatave. Sekretariati është formuar në shkurt të vitit 2012 me Vendimin mbi formimin e strukturës për negociata mbi anëtarësimin e Malit të Zi në BE. Sekretariati është i përbërë prej 19 anëtarësh, përfaqësuesve të MPJIE, dhe punën e tij e udhëheq sekretari i Grupit të negocimit, të cilin e emëron dhe e shkarkon Qeveria me propozim të shefit të Delegacionit shtetëror dhe pëlqimin e Kryenegociatorit.



**Miodrag Radović**

Sekretar i Grupit negociator



**Tatjana Tomiq**

Sekretar i GP 1,6



**Dragana Garbin**

Sekretar i GP 19



**Millena Biro**

Sekretar i GP 3, 4, 5



**Marko Mrdak**

Sekretar i GP 7, 8, 25



**Zorka Kordiq**

Sekretar i GP 9, 17



**Mellita Rastoder**

Sekretar i GP 10, 26, 28



**Vellimir Shlivançanin**

Sekretar i GP 11, 13



**Srgjan Qetkoviç**

Sekretar i GP 2, 12





**Amina Bajrovic**

Sekretar i GP 14, 21



**Sanja Radovic**

Sekretar i GP 15, 27



**Gjorgje Jankovic**

Sekretar i GP 16, 29



**Ana Tomkovic**

Sekretar i GP 18



**Vlladana Mitrovic**

Sekretar i GP 20, 33



**Bojan Vujovic**

Sekretar i GP 22



**Violetë Berishaj**

Sekretar i GP 23



**Millosh Radonjic**

Sekretar i GP 24



**Jelena Llekovic**

Sekretar i GP 30



**Milena Shofranac**

Sekretar i GP 31



**Aleksandër Nikçevic**

Sekretar i GP 32

\*Sekretar i mëparshëm i Grupit negociator, nga formimi deri në shtator të vitit 2014 ishte Millivoje Jurishiq.

## NË VEND TË FJALËS PËRFUNDIMTARE...

Suksesi që e kemi arritur në udhën tonë evropiane, pas dy vite negociatash, është rezultat i përgatitjeve shumëvjeçare, organizimit të mirë dhe bashkërenditjes së punës, punës së zellshme, seriozitetit dhe përgjegjësisë.

Struktura për negociata, që ka më shumë se 1300 persona të kyçur drejtpërdrejt në negociata, ka dhënë një kontribut të pamatshëm në përmbushjen e detyrave evropiane dhe avancimit drejt anëtarësisë në BE. Gjithashtu, mbarë shoqëria malazeze ka treguar një përkushtim të jashtëzakonshëm, një frymë të bashkëpunimit dhe unitetit në realizimin e misionit të përbashkët – anëtarësimi të ardhshëm të Malit të Zi në BE.

Rezultati na gëzon, por edhe na detyron që të vazhdojmë me të njëjtën dinamikë, cilësi dhe përkushtim. Me vetëdije se jemi duke kaluar nëpër etapën më të rëndësishme të maratonës evropiane dhe se rezultati, kryesisht, varet nga ne. Një motiv më tepër për ne është fakti se jemi duke zbatuar reformat jo për shkak të Bashkimit Evropian, por për ne vetë, për shkak të cilësisë më të lartë të jetës dhe të ardhmes më të mirë për të gjithë ne.

Pas dy viteve të negociatave mund të themi se i kemi vendosur themelet e sigurta dhe të mira për të ardhmen tonë evropiane. Dhe më tepër se aq. Jemi të gatshëm që në periudhën e ardhshme të vazhdojmë të ecim me hapa të sigurt drejt Evropës.



me4.eu  
eu4.me  
ja za evropu, evropa za mene